



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:294395

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06378342

C.nr.5144/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.P. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 611.28 euro, jashtë seance, më datë 31.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.P. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- 1) Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.76 euro,
- 2) Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.09.2022, në shumën prej 439.52 euro

Në shumën e përgjithshme prej 611.28 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.12.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t’ia paguaj shumën prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja N.P. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj A.H. avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate përmes shërbimit postar me datë 22.12.2023, ka ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar nga gjykata që ta

detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2021, deri më datën 30.09.2022, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë shkollës “Motrat Qiriazi” në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit e cila i takon paditëses është shuma në lartësi prej 611.28 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 11.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendon paditësi nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, si dhe nga vërtetimi me numër 519/59, të datës 13.12.2023, në versionin e fotokopjuar, lista e pagave EM00112435, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U “Motrat Qiriazi”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënëse që nga viti 2009 dhe vazhdon ende të jetë në marrëdhënie kontraktuale me shkollën. Ndërsa bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë për paditësen, e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ka

vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “*për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “*punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve*”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit, në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 \cdot 3.4\% = 14.31 \cdot 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$).
- Për periudhën Janar-Shtator 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit, në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 439.52 euro ($421 \cdot 11.6\% = 48.83 \cdot 9 \text{ muaj} = 439.52 \text{ euro}$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësit kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, deri me datë 30.09.2022.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së,

duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (23.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.5144/2023, datë 31.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.